

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: MAZREKU SH.P.K., Gurqi, 24000, Malisheve Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	05.09.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës: **05.09.2022**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MAZREKU SH.P.K.** me adresë në Malisheve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MAZREKU SH.P.K.** me adresë në Malisheve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **01.09.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: MAZREKU SH.P.K. me adresë në Malisheve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **01.09.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **05.09.2022**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Ne baze te pretendimit tuaj se AK ka shpërblyer OE i cili ka ofertën prej: 8000 euro!!! (60% mbi vlerën e parashikuar dhe 80.79% mbi vlerën e ofertës sonë).

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Sa i përket ofertave të tenderuesve që ofrojnë çmim mbi vlerën e parashikuar të kontratës, Paragrafi 1 si dhe paragrafi 2.1 i neni 62 të LPP-ës përcaktojnë si në vijim:

Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

"të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit"

Me vet faktin që paragrafi i lartë cituar përmend fjalën **mund** dhe jo kushtimisht **duhet** (ta anuloi aktivitetin e prokurimit) Autoriteti Kontraktues nuk është i obliguar ta anuloi një aktivitet të prokurimit edhe pse të gjithë tenderuesit të përgjegjshëm kanë ofruar çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për atë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se çmimet e ofruara në ofertë janë çmime reale të tregut si dhe ka siguruar mjete shtesë, duke u siguruar me dëshmi me shkrim nga ZKF dhe ZKA, për këtë aktivitet të prokurimit, AK nuk është i obliguar ta anuloi aktivitetin në fjalë, por mund të vazhdojë me procedurë të mëtutjeshme.

Për këtë çështje ka Interpretim nga KRPP-ja dhe Vendim nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 124–125/21.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera në Kërkesën për Rishqyrtim, ju sqarojmë se pretendimi i juaj është i pabazuar pasi që me formular: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar jeni informuar, jeni informuar mbi eliminimin tuaj ne këtë projekt

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit;
Komuna e Rahovecit